



MAKING DEMOCRACY WORK

**VEZHGIM STUDIMOR MBAREKOMBETAR
PER GJYQESORIN
2002**

Rezultatet e Vezhgimit te IFES

**Pergatitur per
Komisionin Qendror te Zgjedhjeve, Shqiperi**

PERMBAJTJA

PARAQITJE	3
PJESA E PARE: Projekti i Vezhgimit Studimor per Gjyqesorin.....	4
PJESA E DYTE: Rezultate paraprake te vezhgimit studimor per Gjyqesorin	6
A. Pyetje te Pergjithshme.....	6
B. Trainimi i Gjyqesorit.....	7
C. Kodi Zgjedhor	9
D. Rinumerimi.....	11
E. Ceshtjet Zgjedhore.....	12
F. Pavaresia e Gjykatave	14
PJESA E TRETE: Komente dhe Vezhgime te IFES.....	15
Trainimi	15
Procedurat dhe Kompetencat	15
SHTESE A	17

PARAQITJE

Ky raport paraqet rezultatet e vezhgimit te pare studimor mbarekombetar per gjyqesorin shqiptar, organizuar nga Fondacioni Nderkombetar per Sistemet e Zgjedhjeve gjate muajit shkurt 2002. Rezultatet e paraqitura ne kete raport bazohen ne te dhenat e marra nga 301 gjyqtare te gjykatave te rrethit, Apelit dhe Gjykates Kushtetuese.

Ky raport eshte i perbere nga tri pjese. Pjesa e pare permban nje paraqitje te pergjithshme te projektit dhe metodologjise se perdorur per te arritur objektivat e tij. Pjesa e dyte e raportit permban rezultatet kryesore mbi ceshtjet qe mbulon pyetesi dhe intervista si dhe klasifikimin e bere per krahasimin e rezultateve. Ne pjesen e trete te ketij raporti IFES-i ka paraqitur komente dhe vleresime ne lidhje me rezultatet dhe rolin e gjyqesorit ne zgjidhjen e mosmarreshjeve zgjedhore.

Ky vezhgim eshte nje menyre e mire per percaktimin e nivelit te pervojës dhe marrjen e mendimit te gjyqesorit, per te patur nje koncept te qarte ne lidhje me prioritetet e trainimit te gjyqesorit perpara zgjedhjeve lokale 2003.

PJESA E PARE: Projekti i Vezhgimit Studimor per Gjyqesorin

Kodi i ri zgjedhor ka percaktuar rregulla te reja dhe nje perfshirje te te gjitha shkalleve te gjykates ne zgjidhjen e mosmarreshjeve zgjedhore. Gjate zgjedhjeve te kaluara, gjyqesori eshte marre me nje numer ceshtjesh zgjedhore duke e futur keshtu gjykatën ne nje fushe me pak pervoje. Gjithashtu pas zgjedhjeve lokale 2000 dhe atyre parlamentare 2001 nje nga problemet e identifikuar ne raportin e ODIHR-it ishte dhe menyra e zgjidhjes se mosmarreshjeve gjyqesore nga Gjykatat.

Duke marre parasysh problemet e hasura nga gjykatat dhe komentet e ODIHR-it, eshte e qarte se duhen bere perpjekje te metejshme per permiresimin e profesionalizmit dhe integritetit te gjykatave. Ne keto kushte ishte e rendesishme te percaktohej ndikimi qe kishte patur trainimi i organizuar nga shkolla e magjistratures, te percakohen fushat qe kerkojne trainim si dhe te merrej mendimi i gjyqtareve ne lidhje me ndryshime te mundshme te ligjit zgjedhor apo procedurave perkatese ne menyre qe gjyqesori te permbushe detyrimet e tij. Objektivat e ketij vezhgimi studimor ishin:

- Marrja e mendimit te gjyqtareve ne lidhje me zgjedhjet parlamentare 2001
- Percaktimi i pikave te forta dhe dobesive te procedurave gjyqesore
- Percaktimi i ndikimit qe pati trainimi i organizuar nga shkolla e magjistratures
- Percaktimi i programeve te metejshme te trainimit per gjyqesorin
- Percaktimi i procedurave qe duhet te percaktohen ne te ardhmen

Vezhgimi studimor per Gjyqesorin u zhvillua ne periudhen dhjetor 2001 – mars 2002. Perpjekja e pare qe u be ne kete drejtim ishte paraqitja e pyetesorit ne konferencen vjetore te gjyqesorit, ne dhjetor 2001 ku pyetesori ishte pergatitur ne formen e nje pyetesori individual, te cilet do te plotesoheshin dhe dorezoheshin ne fund te konferences. Duke gene se nuk u arrit dorezimi i te gjitha pyetesoreve te shperndare, u vendos organizimi i vezhgimit per gjyqtaret, ne formen e intervistave gjate vitit 2002. IFES-i dhe KQZ-ja pergatiten nje pyetesori te dyle, duke e pershtatur per kryerjen e nje interviste.

Pyetesori ishte i perbere nga shtate pjese:

- Informacion i pergjithshem
- Trainimi i organizuar nga shkolla e magjistratures
- Kodi Zgjedhor dhe fushat e mundshme te permiresimit
- Procesi i Rinumerimit
- Ceshtjet zgjedhore qe kane gjykuar gjykatat
- Gjykatat dhe juridiksioni perkates sipas Kodit Zgjedhor
- Pavaresia e gjyqesorit

Intervistat u kryen ne baze prefektore, nga nje grup intervistuesish, ku perfshiheshin intervistues nga projekti i pare, te cilet u perzgjedhen ne baze te punes se kryer gjate projektit te pare te vezhgimit per anetaret e komisioneve zgjedhore, si dhe ne baze te njohurive te tyre ne fushen juridike dhe nga studente te Fakultetit te Drejtesise.

U perzgjodhen 15 intervistues, nje per cdo prefektore dhe kater per Tiranen te cilet u trainuan ne nje program dy ditor ne shkurt, i cili perfshinte njohuri te pergjithshme juridike, nder te cilat

- Sistemi Gjyqesor i Shqiperise
- Roli i Gjykatave ne baze te Kodit Zgjedhor dhe
- Roli i gjykatave gjate zgjedhjeve parlamentare 2001 dhe problemet e hasura

Si dhe pjesen praktike:

- Njohjen e pergjithshme me projektin
- Njohjen dhe analizen e pyetesorit
- Menyren e plotesimit te pyetesorit
- Tekniken e intervistimit dhe specifikat e punes me gjyqtaret

Secilit prej intervistuesve iu dha lista perkatese e gjyqtareve si dhe numrat e kontaktit, nderkohe qe KQZ-ja i kishte njoftuar me anen e nje letre kryetarin e Gjykates se Larte dhe Kryetaret e Gjykatave ne rrethe per te bere te mundur kryerjen e ketij projekti.

Projekti u krye ne nje periudhe tre javore ne shkurt 2002, ndjekur nga nje takim permbledhes me intervistuesit. Ne pergjithesi intervistuesit raportuan se gjeten mbeshjetjen e plote te kryetareve te gjykatave dhe interesimin e vete gjyqtareve ne kete projekt. Me perjashtim te rrethit te Tiranës, ku interesimi nga ana e gjyqtareve ishte ne nivelin me te ulet. Megjithate nga 351 gjyqtare qe ishin planifikuar te intervistohen, u arrit te kryhen 301 intervista qe perbejne rreth 85% te gjyqtareve ne shkalle vendi. Megjithe perpjekjet e bera nuk u arrit te intervistoheshin gjyqtaret e Gjykates se Larte.

Ne pergjithesi eshte vene re nje tendence per te mos dhene shume mendime ne pyetjet e hapura dhe kjo eshte justifikuar me faktin se jo te gjithe gjyqtaret, vetem 49 prej tyre, kane qene te perfshire ne procesin zgjedhor dhe se ka kaluar nje kohe e gjate dhe nuk jane ne gjendje te shprehin mendime te sakta ne lidhje me dispozitat e vecanta te kodit zgjedhor, ne lidhje me te cilat kishin pervoje te paket.

PJESA E DYTE: Rezultate paraprake te vzhgimit studimor per Gjyqesorin

A. Pyetje te Pergjithshme

- Persa i perket pjeses se pare te pyetesorit ne informacionet e pergjithshme, deri tani eshte analizuar vetem numri i gjyqtareve qe kane marre pjese ne kete projekt. Keshtu nga 351 gjyqtare qe ishin parashikur te intervistohen, u arrit te kryen 301 intervista, te cilat perbejne 85% te gjyqtareve ne shkalle vendi.
- Nga te intervistuarit, 65% (197) ishin burra dhe 35% (104) gra. Perqindja me e larte e grave i perket prefekturave te Durresit (51%/18), Fierit (42%/10), Korces (38%/13) dhe Kukesit (46%/5). Perqindja me e ulet eshte vene re ne Prefekturat e Lezhes (11%/1) dhe Dibres (14%/2)

Figura 1: Numri i Gjyqtareve ne Nivel Prefektur

Prefektura	Numri i gjyqtareve te intervistuar	Gjykata Kushtetuese	Gjykata e Apelit	Gjykata e Rrethit
BERAT	11			11
DIBER	14			14
DURRES	35		7	28
ELBASAN	26			26
FIER	24			24
GJIROKASTER	21		4	17
KORCE	34		6	28
KUKES	11			11
LEZHE	9			9
SHKODER	27		5	22
TIRANE	63	8	10	45
VLORE	26		5	21
TOTAL	301	8	37	256

Numri i Gjyqtareve ne Shqiperi


	Numri Aktual	Gjykata Kushtetuese	Gjykata e Larte	Gjykata e Apelit	Gjykata e Rrethit
TOTAL	351	9	15	39	288

B. Trainimi i Gjyqesorit

Pyetjet e drejtuara gjyqtareve ishin te lidhura me programin e trainimit te organizuar nga shkolla e magistratures. Ne pergjithesi per pyetjen e pare “a keni marre pjese ne trainim?”

- 72% (217) e te intervistuarve (62% te te gjithe gjyqtareve) kane thene se kane marre pjese ne kete trainim, ndersa 28% (84) nuk kane marre pjese ne trainim. Ka nje ndryshim te ndjeshem ndermjet gjyqtareve me nje eksperience te gjate pune dhe gjyqtareve me te rinj. Nga vezhgimi u vu re se 53% (33) e atyre qe kane nje pervoje pune 1 deri ne 3 vjet. Nga keta te fundit arsyet per te cilat nuk kane marre pjese kane qene ne pergjithesi arsye pune dhe mungese njoftimi per seminarin.

Figure 2: Pjesemarrja ne seminar ne baze te pervojes ne pune



- Ne lidhje me pyetjet qe u jane drejtuar, 98% e atyre qe kane marre pjese ne trainim mendojne se trainimi ka qene i nevojshem. 80% (174) mendojne se trainimi ka qene i mireorganizuar dhe 18% (38) mendojne se jo. Shumica e gjyqtareve qe kane marre pjese ne trainim jane te kenaqur me menyren e organizimit te tij. 74% (160) e gjyqtareve pjesemarres mendojne se trainuesit mund t’u pergjigjeshin pyetjeve te tyre, ndersa numri i atyre qe mendojne se trainimi ishte i kuptueshem eshte 68% (148). Gjyqtaret me me pak eksperience (1-3 vjet) jane me te prirur te mos bien dakord me faktin se trainimi ishte i qarte dhe i detajuar (36%/12). Ky fakt vjen ndoshta si rezultat i pervojes dhe perballjes se paket qe keta gjyqtare kane patur me ceshtje te ndryshme dhe mund te jete tregues i faktit se trainimet per keto dy grupe duhet te behen te shkeputura.


Figura 3: Vleresimi i Aspekteve te Trainimit (Te Intervistuar = 217)

	Dakord	Nuk jam dakord	Nuk e di
Programi i Trainimit ishte i nevojshëm	98%	1%	1%
Programi i Trainimit ishte i mirëorganizuar	80%	18%	2%
Specialistët ishin në gjendje t'u jepnin përgjigje pyetjeve tona	74%	23%	3%
Programi i Trainimit ishte i detajuar dhe sqarues	68%	27%	5%
Të gjithë gjyqtarët duhet të kishin marrë pjesë në programin e trainimit	94%	5%	1%
Gjyqtarët duhet të trainohen përpara cdo procesi zgjedhor	86%	11%	3%

- Nderkohe qe ne lidhje me faktin se te gjithë gjyqtaret duhet te kishin mare pjese ne trainim 94% (203) e atyre qe kane marre pjese ne trainim, mendojne se po dhe 86% (186) e gjyqtareve, mendojne se eshte e nevojshme qe gjyqtaret te trainohen perpara cdo procesi zgjedhor.
- Gjyqtaret jane pyetur gjithashtu edhe nese gjykata e tyre ka organizuar trainime ne lidhje me procesin zgjedhor per zgjedhjet e qershorit 2001. Vetem 32% (96) e gjyqtareve te intervistuar jane pergjigjur se gjykata ka organizuar trainime permblledhese perpara zgjedhjeve. Ne Berat, Diber, Gjirokaster dhe Lezhe, asnje nga gjyqtaret e intervistuar nuk eshte pergjigjur se ka patur trainime te tilla. Ne Shkoder (63%/17) eshte regjistruar numri me i madh i pergjigjeve se ka patur trainim shtese organizuar nga gjykata. Ne prefekturat e tjera perqindja e gjyqtareve qe jane pergjigjur se kane marre pjese ne trainime te organizuar nga gjykata ka qene midis 32% dhe 46%.
- Nje nga pyetjet e tjera qe lidhen me trainimin ka qene nese jane te mendimit se te gjithë gjyqtaret duhet te trainohen ne lidhje me mosmarreshjet zgjedhore. 89% (267) e te intervistuarve mendojne se po. Ndersa te pyetur per vendin, ne nje perqindje te njejte gjyqtaret mendojne se trainimi duhet te kryhet ne nivel rrethi gjyqesor (37%/112), te ndjekur nga mendimi se trainimi duhet te kryhet ne Tirane (37%/110). Gjyqtaret e Tiranës jane ne pergjithesi kunder mendimit se trainimi duhet te kryhet ne Tirane (14%/9) dhe me te prirur ndaj mendimit se trainimi duhet te kryhet ne nivel rrethi gjyqesor (51%/32).
- Shumica e te intervistuarve (29%/88) mendojne se trainimi duhet te organizohet nga eksperte nderkombetare. Nje perqindje domethenese ka permendur Gjykatën e Larte (28%/83) dhe KQZ-ne (22%/65). Persa i perket kohes kur duhet te kryhet ky trainim, pjesa me e madhe eshte pergjigjur se trainimi duhet te kryhet menjehere pas daljes se dekretit te Presidentit per shpalljen e dates se zgjedhjeve (84%/253).

- Gjyqtaret jane pyetur gjithashtu edhe ne lidhje me ceshtjet qe duhet te mbuloje ky trainim. Pergjigjet me te shpeshta kane qene ceshtjet gjyqesore (46%/140). Pervec pergjigjes se trainimi duhet te perfshije cdo ceshtje qe parashikohet nga Kodi Zgjedhor (26%/79), pergjigje te tjera me te shpeshta kane qene edhe ankesat dhe ceshtjet zgjedhore (22%/65), rinumerimi (13%/38), afatet proceduriale (8%/25) dhe ceshtje ne lidhje me listat zgjedhore (5%/15).

Figura 4: Ceshtje te Mundshme per Trainim (Te Intervistuar =301)




C. Kodi Zgjedhor

- Ne pjesen qe i perket kodit zgjedhor gjyqtaret jane pyetur ne lidhje me qartesine e percaktimit te vendimeve qe merren nga gjykatat e ndryshme ne baze te kodit zgjedhor. Lidhur me kete pyetje, 51% (153) mendojne se po dhe 41 % (122) mendojne se nuk jane te percaktuara qarte. Bie ne sy fakti se asnje nga gjyqtaret e Gjykates Kushtetuese nuk mendon se Kodi eshte i qarte ne lidhje me vendimet qe i perkasin seciles gjykate.
- Te pyetur se ku qendron mungesa e qartesise, pjesa me e madhe e te intervistuarve mendon se paqartesia qendron ne kompetencat (42%/51) dhe dispozitat perkatese (21%/25).
- Pyetja tjetere ka te beje me faktin nese kodi zgjedhor duhet te permbaje procedura te detajuara qe duhet te ndiqen nga gjykatat dhe 92% (276) e te intervistuarve mendojne se Kodi Zgjedhor duhet te perfshije procedura te detajuara.

Persa i perket atyre qe mendojne se keto procedura nuk duhet te perfshihen ne kodin zgjedhore, pjesa me e madhe e tyre mendojne se duhet te perdoren procedurat ekzistuese si Kodi i Procedures Civile, ose keto procedura mund te permblidhen ne nje dokument te vecante.

- Te pyetur nese eshte e nevojshme te percaktohen qarte kriteret mbi te cilat duhet te mbeshtetet gjykata gjate shqyrtimit te mosmarreshjeve zgjedhore, nga te intervistuarit, 89% (267) e tyre mendojne se po dhe 75% (201) e te intervistuarve mendojne se duhet te percaktohen ne kodin zgjedhor ndersa 17 % (46) mendojne se duhet te percaktohen ne nje dokument te vecante.
- Gjyqtaret jane pyetur ne lidhje me njohurite qe kane per afatet proceduriale te percaktuara ne kodin zgjedhor dhe 74% (222) e tyre jane pergjigjur se i njohin plotesisht keto afate ndersa 19% (56) deklarojne se i njohin ato pjeserisht. Sikurse pritej gjyqtaret me me pervoje jane me te njohur me afatet proceduriale sesa ata me me pak pervoje. Keshtu, ndersa gjyqtaret me 10 e me shume vjet pervoje i njohin keto afate ne masen 81% (56), kjo perqindje zbrit ne 52% (32) per ata gjyqtare me 1-3 vjet pervoje. 48% (134) e gjyqtareve qe i njohin keto afate jane te mendimit se ceshtjet mund te zgjidhen objektivisht brenda ketyre afateve, ndersa 46% (129) mendojne se nuk eshte e mundur qe ceshtjet te zgjidhen objektivisht duke respektuar keto afate.
- Ne lidhje me ndryshimet qe mund t'i behen Kodit Zgjedhor, 44% (132) e gjyqtareve nuk i ka dhene pergjigje kesaj pyetje. Ne pergjithesi gjyqtaret me me pervoje kane mbeshtetur ndryshimet ne Kod. Ndryshimet qe jane permendur me shpesh kane qene ndryshime ne afatet kohore (12%/35), procedura me te qarta (10%/30), nje Kod me i detajuar (7%/22), qartesim i rolit te gjykates (7%/22), percaktimi i kriterave per zgjidhjen e mosmarreshjeve zgjedhore (6%/19), kufizimi i rolit te gjykates (6%/17) dhe procedurat e rinerimit (6%/17).

Figure 5: Ndryshime te Rekomanduara per Kodin Zgjedhor (Te Intervistuar=301)



- Një tjetër pyetje ka qenë edhe pyetja që lidhet me nevojën e ngritjes së një organi investigues që merret me shqyrtimin e parregullsisë zgjedhore. Në lidhje me këtë pyetje, 48% (145) mendojnë se një organ i tillë është shumë i nevojshëm, 20% (61) mendojnë deri diku të nevojshëm dhe 27% (80) nuk e konsiderojnë aspak të nevojshëm, duke dashur ndoshta të evitojnë problemet e hasura gjatë zgjedhjeve parlamentare 2001. Përqindja më e lartë e gjyqtarëve që mendojnë se ky organ është i rëndësishëm, është i gjyqtarëve të Apelit (62%/23) në krahasim me gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit (47%/121). Nderkohe që prej atyre që e mendojnë si organ shumë, ose disi të nevojshëm, të pyetur prane kujt duhet të ngrihet ky organ, 59% (121) mendojnë se duhet të ngrihet prane KQZ-së dhe 15% (31) mendojnë se duhet ngritur prane gjykatës dhe vetëm 5% (10) mendojnë se duhet të ngrihet prane prokurorisë.

D. Rinumerimi

- Gjyqtarët janë pyetur në lidhje me procedurat e rinumerimit si dhe rolin e gjykatës në rinumerimin e votave. Më pas janë dhënë dhe detajet në lidhje me përgjigjet e këtyre pyetjeve.
- Në lidhje me pyetjen që lidhet me rinumerimin, kush duhet të jetë përgjegjës për rinumerimin 47% (142) mendojnë se përgjegjës për rinumerimin duhet të jetë gjykata e rrethit, 23% (69) mendojnë se rinumerimi duhet të jetë përgjegjësi e KQZ-së dhe 23% (69) mendojnë se duhet të jetë një organ i vecantë i cili duhet të merret me rinumerimet. Bie në sy fakti se gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese (63%/5) dhe ata të Gjykatës së Apelit (51%/19), mendojnë se rinumerimi duhet të jetë përgjegjësi e Gjykatës së Rrethit (53%/24), ndërsa vetë gjyqtarët e shkallës së parë, janë më pak të prirur ndaj këtij mendimi (46%/118).

- Ne lidhje me pervojen e drejtperdrejte ne rinumerim, nga te intervistuarit vetem 16% (49) e tyre kane marre pjese ne procesin e rinumerimit. Ne Berat, Fier dhe Gjirokastr, asnje nga gjyqtaret e intervistuar nuk ka marre pjese ne ndonje proces rinumerimi. Ne Diber, Kukes dhe Vlore, vetem nje gjyqtar ka marre pjese ne rinumerimin e votave. Ne Lezhe pese nga nente gjyqtaret e intervistuar jane marre drejtperdrejte me rinumerimet, ndersa me se 20% e gjyqtareve ne Korce (29%/10), Durres (29%/10) dhe Tirane (25%/16) jane pergjigjur se gjykata e tyre ka patur raste te rinumerimeve.
- Nga gjyqtaret qe kane marre pjese ne rinumerime, 29% (14) mendojne se procedurat e rinumerimit ne kapitullin 8 te Kodit Zgjedhor jane te qarta, 53% (26) mendojne se keto procedura jane pjeserisht te qarta dhe 10% (5) mendojne se nuk jane aspak te qarta. Keto perqindje te cojne drejt nevojës per ndryshime ne kete kapitull, ndryshime qe detajohen edhe me poshte.
- Keshtu, ne lidhje me menyren e permiresimit te procedurave te rinumerimit, 48% (144) nuk jane pergjigjur, gje qe lidhet edhe me faktin se pjesa me e madhe e te intervistuarve nuk kane marre pjese ne rinumerime. Pergjigja me e shpeshte ka qene se Kodi duhet te perfshije procedura me te qarta e te detajuara (15%/45) ndersa nje pjese e konsiderueshme (14%/42) mendon se gjykata duhet te perjashtohet nga rinumerimi, gje qe lidhet ndoshta edhe me problemet e hasura gjate zgjedhjeve parlamentare 2001. Sugjerime te tjera kane qene edhe ne lidhje me ndryshimin e legjislacionit qe rregullon rinumerimin (8%/25) dhe percaktimin e kriterëve per rinumerimin (5%/15). Jane permendur gjithashtu edhe afate me te gjata kohore (2%/6).

E. Ceshtjet Zgjedhore

Gjyqtareve u eshte paraqitur nje liste me ceshtje te ndryshme zgjedhore dhe u eshte kerkuar te percaktojne nese kane patur raste te tilla dhe numrin perkates. Ceshtje e paraqitura kane qene:

Persona të lënë jashtë listave
 Zëvendësim i Anëtarëve të Komisioneve Zgjedhore
 Protokolle të Qendrave të Votimit
 Shpallje e Rezultateve të Zonës Zgjedhore
 Emërimi i Kandidatëve (përfshirë edhe kandidatët e pavarur)
 Vendime të KQZ-se
 Ceshtje te tjera

Perqindjet e pergjigjeve te dhena nga gjyqtaret jane dhene ne listen e meposhteme:

Persona të lënë jashtë listave	48%/144
Shpallje e Rezultateve të Zonës Zgjedhore	15%/45
Zëvendësim i Anëtarëve të Komisioneve Zgjedhore	11%/34
Vendime të KQZ-se	10%/30
Protokolle të Qendrave të Votimit	8%/25

- Ceshtjet qe lidheshin me listat e zgjedhjeve kane qene me te permendurat nga gjyqtaret. Te pyetur nese keto ceshtje jane paraqitur nga partite apo kandidatet, shumica e gjyqtareve nuk kane dhene pergjigje. Ata qe jane pergjigjur kane permendur nga partite dhe kandidatet se bashku (16%/27), ndjekur nga partite politike (15%/25) dhe kandidatet (18%/3). Per rastet e tjera, ne pergjithesi gjyqtaret jane pergjigjur nga partite dhe kandidatet se bashku pa specifikuar njerin apo tjetrin.
- Gjyqtaret jane pyetur me pas edhe ne lidhje me procedurat qe kane perdorur gjate shqyrtimit te mosmarreshjeve zgjedhore dhe ne pjesen me te madhe jane pergjigjur se kane ndjekur procedurat e parashikuara nga Kodi Zgjedhor (43%/85). Ka patur te tjere qe jane pergjigjur se kane ndjekur procedurat e Kodit te Procedures Civile (13%/25) dhe te tjere kane dhene pergjigje qe kombinone Kodin Zgjedhor dhe Kodin e Procedures Civile (4%/8). Ka patur shume gjyqtare, te cilet jane pergjigjur se kane zbatuar ligjin, pa percaktuar se cilit ligj i referohen (25%/49), si dhe nje pjese qe eshte pergjigjur se nuk ka ndjekur procedura te formalizuara (10%/20). Keto pergjigje tregojne se Kodi Zgjedhor nuk eshte mjaft i kuptueshem apo i mjaftueshem per gjyqtaret ne lidhje me mosmarreshjet zgjedhore. Permiresimet ne Kodin Zgjedhor dhe trainimi i vazhdueshem i gjyqtareve te lidhje me Kodin Zgjedhor jane te detyrueshem per permiresimin e kesaj gjendjeje.
- Te pyetur ne lidhje me perdorimin e udhezimeve te KQZ-se gjate shqyrtimit te mosmarreshjeve zgjedhore, gjyqtaret ne pjesen me te madhe (64%/125) jane pergjigjur se i kane marre parasysh keto udhezime. Megjithate 32% (63) jane pergjigjur se nuk i kane perdorur ato. Perdorimi i udhezimeve te KQZ-se lidhet perseri me pervojen e gjyqtareve. Pjesa me e madhe e gjyqtareve qe nuk i kane perdorur keto udhezime (53%/18) kane nje eksperience pune prej 1-3 vjet dhe kjo perqindje ulet tek gjyqtaret me me shume eksperience (28%/45). Kjo tregon se KQZ-ja duhet te beje me shume perpjekje per te informuar gjyqtaret ne lidhje me rolin e tij ne zgjidhjen e mosmarreshjeve zgjedhore.
- Ne lidhje me permiresimin e ketyre udhezimeve, pjesa me e madhe e gjyqtareve mendon se udhezimet duhet te jene me te plota e te detajuara (23%/43) dhe t'i behen te njohura gjykates qe me pare (11%/21).
- Persa i perket marredhenieve te gjykatave me KQZ-ne, mendimi i atyre gjyqtareve qe kane patur kontakte me KQZ-ne, ka qene se keto marredhenie kane qene 'shume te mira' dhe 'te mira' (93%/173). Ndersa 38% (115) gjyqtare jane pergjigjur se nuk kane patur kontakte me KQZ-ne.
- Nje tjetër pyetje me interes ka qene edhe pyetja qe lidhet me faktin nese gjyqtaret mendojne se partite politike kane paraqitur ne gjykate raste qe nuk mbeshteten ne shkelje konkrete. Ne lidhje me kete pyetje nje pjese e madhe eshte pergjigjur se

po 40% (121), 16% (47) janë përgjigjur jo dhe 43% (130), ndërsa një pjesë tjetër e konsiderueshme është përgjigjur se nuk mund të japë përgjigje të sakte. Me kritike kanë qenë gjyqtarët e Elbasanit, 39% (10) e të cilëve janë përgjigjur se ankimet nuk kanë qenë të mbështetura në ligj.

F. Pavarësia e Gjykatave

- Dy pyetjet e fundit lidheshin me pavarësinë e gjyqësorit në zgjidhjen e mosmarreveshjeve zgjedhore. Në lidhje me pyetjen e parë nëse gjyqtarët kanë qenë të paanshem në zgjidhjen e mosmarreveshjeve zgjedhore gjatë zgjedhjeve parlamentare 2001, 82% (247) e gjyqtarëve mendojnë se gjyqtarët kanë qenë të paanshem dhe vetëm 11% (34) mendojnë se jo.
- Nder këta të fundit, gjyqtarët që mendojnë se gjyqësori nuk ka qenë i pavarur, të pyetur në lidhje me menyrat e rritjes së pavarësisë së gjyqësorit në të ardhmen, përgjigjet me të shpeshta kanë qenë, një rol më i përcaktuar i gjykates (24%/9), hapësira dhe garanci ligjore (16%/6) dhe respektim i pavarësisë së gjyqësorit (13%/5).

PJESA E TRETE: Komente dhe Vezhgime te IFES

Nje nga ndryshimet e Kodit Zgjedhor te miratuar nga Kuvendi i Shqiperise ne maj 2000, ishte perfshirja per here te pare e gjykatave ne rinumerimin e votave dhe shqyrtimin e mosmarreveshjeve zgjedhore. Vendimi per te perfshire gjykatat ne kete proces ishte nje perpjekje per te depolitizuar procesin zgjedhor ne nivelin e komisionereve lokale. Perfshirja e gjykatave u paraqit si nje sfide, si per partite politike ashtu edhe per gjykatat. Gjate zgjedhjeve lokale procedurat e vendosura per t'ju krijuar mundesi partive politike per te paraqitur raste te ndryshme ne gjykate, nuk u perdoren plotesisht. Ne vend te ketyre procedurave, partite politike dhe kandidatet i paraqiten ceshtjet e tyre ne KQZ, organ i cili nuk ishte ne gjendje t'i shqyrtonte ato. Ne rastet kur keto ceshtje u paraqiten perpara gjykatave, keto te fundit nuk ishin ne gjendje te vendosnin se si do t'i trajtonin ato. Gjate zgjedhjeve per kuvendin 2001, kandidatet dhe partite iu drejtuar me teper rrugeve gjyqesore. Ceshtjet qe u shqyrtuan nga gjyqesori gjate dhe pas zgjedhjeve arriten deri ne 1000.

Perpara zgjedhjeve lokale 2000, nje trainim formal i gjyqesorit ishte i pamundur. Megjithate, Gjykata e Larte organizoi nje seminar njeditor per te diskutuar ne lidhje me ceshtje te ndryshme lidhur me mosmarreveshjet zgjedhore. Kjo iniciative u sponsorizua nga IFES-i dhe Keshilli i Evropes. Seminari u shoqerua me nje numer programesh te shkolles se Magjistratures me gjyqtare nga i gjithë vendi gjate muajve prill dhe maj 2001. Ky program u sponsorizua nga IFES-i, ndersa Keshilli i Evropes ofroi nje numer specialistesh, te cilet asistuan ne pergatitjen e programit.

Vezhgimi Studimor per Gjyqesorin i ndermarre nga IFES-i ne shkurt 2002, tregoi qarte se pavaresisht se ne trainimin e organizuar nga Shkolla e Magjistratures ka mare pjese nje numer i konsiderueshem gjyqtaresh, ky program nuk u shoqerua me seminare ne cdo rreth gjyqesor apo brenda cdo niveli te gjykatave ne Shqiperi. Gjithashtu, vezhgimi ka nxjerre ne pah nevojën per te percaktuar procedura te qarta per te gjithë shkallet e gjyqesorit ne Shqiperi.

Trainimi

Shqyrtimi i mosmarreveshjeve zgjedhore, eshte nje fushe e re ne legjislacionin shqiptar. Si rrjedhim eshte e nevojshme qe gjyqesori te trainohet ne menyre te vazhdueshme ne kete fushe. Kjo nevojë e gjyqesorit eshte shprehur qarte dhe ne kete vezhgim. Programe te vazhdueshme te Shkolles se Magjistratures do te ishin te nevojshme. Gjithashtu, eshte e keshillueshme qe ne Fakultetin e Drejtesise, Universiteti i Tiranes, te perfshihet edhe nje kurs mbi ligjin zgjedhor.

Procedurat dhe Kompetencat

Kur u hartua Kodi Zgjedhor, u mendua se gjykatat do te ndiqnin procedurat e perfshira ne te dhe jo ato te Kodit te Procedures Civile. Ky ishte dhe nje burim konfuzioni gjate zgjedhjeve lokale 2000, i reduktuar gjate zgjedhjeve parlamentare 2001. Megjithate,

ashtu sikurse vihet re edhe ne kete studim, procedurat e kodit nuk jane zbatuar gjithmone ne te njejten menyre.

Vezhgimi Studimor shpreh gjithashtu edhe pikepamje te ndryshme brenda sistemit gjyqesor ne lidhje me nivelet perkatese te gjykatave, te cilat duhet te gjykojne ceshtje qe kane te bejne me zgjedhjet. Duhet te theksojme se pikepamje te tilla te ndryshme vihen re edhe jashte ketij sistemi. Vezhgimi tregon se gjyqtaret mendojne se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet te kete kompetenca te qarta investigimi per te trajtuar nje ankese perpara se te behet shqyrtimi gjyqesor dhe vendimi. E treta, te dhenat e vezhimit jane ne mbeshtetje te idese per krijimin e nje gjykate te vecante (te perkohshme) e cila do te gjykoje te gjitha mosmarreshjet zgjedhore. Keto tre ceshtje (si dhe nje perqartsim i metejshem ne ligj ne lidhje me rinumerimin e votave), jane ndermjet ceshtjeve me te rendesishme qe mund te merren ne konsiderate nga ligjvenesit.

Gjate ketij viti, Kuvendi i Shqiperise si dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do te marrin ne konsiderate ndryshime te mundshme ne Kodin Zgjedhor. Gjate ketij procesi do te ishte e keshillueshme per te dyja keto organe te konsultoheshin edhe me gjyqesorin per te propozuar ndryshimet e duhura ne Kodin Zgjedhor. Ne javet dhe muajt ne vijim, IFES-i do te paraqese disa sugjerime ne lidhje me keto ceshtje me synim qartesimin e problemeve dhe forcimin e procesit ligjor per te siguruar transparence dhe drejtesi ne sistemin zgjedhor.

Se fundi, ne pergatitje te zgjedhjeve te ardhshme, IFES-i do te vazhdoje te sponsorizojte programe te vecanta trajnimi per gjyqesorin per ceshtje qe kane te bejne me Kodin Zgjedhor dhe sistemin zgjedhor per te ndihmuar gjyqesorin ne permbushjen e pergjegjesive te tij.

SHTESE A